



V E N D I M

Nr. 24 Datë 22.02. 2008

Për

**kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” shpk për kualifikimin e
impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhe) si burime
te rinovueshem energjie**

Në mbështetje të nenit 9, dhe nenit 39, pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa a, te Vendimit te Bordit te Komisionereve Nr. 9, date 21.02.2007, “Rregullores se Procedurave te Certifikimit te Prodhimit te Energjise Elektrike nga Burimet e Rinovueshme”, Vendimit te Bordit te Komisionereve Nr. 44, date 24.07.2007 “Per Miratimin e Rregullave te Praktikes dhe Procedurave te ERE-s” neni 15, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “E.R.E”, në mbledhjen e tij të dates 22.02.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” shpk për kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhe) si burime te rinovueshem energjie

Vendosi

1. Kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhe) te shoqerise “Biopower Green Energy” shpk, si burime te rinovueshem energjie.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria e Ceshjeve Ligjore dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftojne aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.